

PROTOKOLL

Mbledhja e katërt e kryesisë së shoqatës e thirrur nga kryetari Ismet Abdyli

Data: 05.07.2018

Ora: 20:30

Vendi: Glattbrugg

Pjesmarrës: Ismet Abdyli, Muhamet Guda, Avni Kastrati, Imran Asllani, Musa Halili

Mungon: Fadil Kqiku , Qenan Haziri

Temat e ditës:

1. Punëtori i shoqatës

Deri më tani nuk kemi të interesuar për punëtor të shoqatës.

2. Shportat në park

Shportat te parku i dëshmorëve janë të dëmtuara në masë të madhe. Avni Kastrati obligohet të gjejë dikend që do ti riparoj shportat.

3. Loptopi për mësuesin

Kryesia e shoqatës 17shkurti.ch ka vendosur të shpërblej me një laptop profesorin e Kimis Ilir Kastratin i cili ka treguar rezultate të shkëlqyeshme me nxënësit e shkollës tonë gjatë viteve të fundit.

4. Nxënësit më të dalluar

Pas një bisede me drejtorin e shkollës fillore ka mbetur që drejtori së bashku me stafin e profesorëve ti gjejë nxënësit më të dalluar. Me këtë rast kryesia e shoqatës ka vendosur ti shpërblej 5 nxënës me nga 20CHF.

Kryesia e shoqatës në të ardhmen pret prej drejtorit të na dërgojnë listen e nxënësve më të dalluar para se të mbyllet viti shkollor.

5. Drita LED

Pas aksionit të sukseshëm për ndriqimit të hapsirave publike me drita LED kemi kërkesa të reja nga bashkfshatarët për ndriqime shtesë. Kryesia e mbështetë këtë projekt dhe merr vendim për ndriqimin e 10 hapsirave të ndryshme në ditët në vazhdim.

6. Të ndryshme

Qamil Sadriu ndan 400 € për javën kulturore Doberqani 2018 për nderë të dëshmorëve..

Vitin e kaluar kemi ndar 200 CHF për pagesën e rrugës Doberqan-Gjilan dhe anasjelltas për 2 nxansa në nevojë (Fëmijët e Hajrullah Zeqirovcit). Kryesia merr vendim që edhe këtë vitë të bëhet ndihmesa e njejtë.